



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 232

Tiranë – E mërkurë, 30 dhjetor 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1087, datë 24.12.2020	Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2021..... 18785

**VENDIM****Nr. 1087, datë 24.12.2020****PËR MIRATIMIN DHE PUBLIKIMIN
ZYRTAR TË NOMENKLATURËS SË
KOMBINUAR TË MALLRAVE, 2021¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 e 12, të ligjit nr. 9461, datë 21.12.2005, “Për nomenklaturën e kombinuar të mallrave dhe tarifën e integruar doganore”, të ndryshuar; me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2021, sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Vendimi nr. 846, datë 24.12.2019, i Këshillit të Ministrave, “Për miratimin dhe publikimin zyrtar të Nomenklaturës së Kombinuar të Mallrave, 2020”, shfuqizohet.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrinë efektet nga data 1.1.2021.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

¹ Përafruar pjesërisht me Rregulloren Zbatuese të Komisionit (EU) 2020/1577, amendim i Rregullores së Këshillit Evropian (EEC) nr.2658/87, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L 361, datë 21.9.2020.

NOMENKLATURA E KOMBINUAR
E MALLRAVE 2021

PERMBLEDHJE

PJESA E PARE – DISPOZITAT PARAPRAKE

Seksioni I – Rregullat e pergjithshme

- A. Rregullat e pergjithshme per interpretimin e Nomenklatures se Kombinuar

Seksioni II – Dispozita Speciale

- A. Mallrat per kategori te caktuara te anijeve, vaporeve dhe mjeteve te tjera lundruese dhe per platformat shpuese apo te prodhimit.
B. Avionet civil dhe mallrat per perdorim ne aviacionin civil
C. Produktet farmaceutike
D. Kontenieret dhe materialet paketuese
E. Trajtimi tarifar favorizues sipas natyres se mallrave Shenjat, shkurtime dhe simbolet
Njesite suplementare

PJESA E DYTE – LISTA E TAKSAVE DOGANORE

Seksioni I

KAFSHET E GJALLA; PRODUKTET ME ORIGJINE PREJ KAFSHEVE

1. Kafshet e gjalla.
2. Mishi dhe te brendeshmet e ngrenshme te mishit
3. Peshku dhe kafshet guackore te nenujshme, molusqet dhe kafshet e tjera jovetebrore ujore
4. Produktet bulmetore; vezet e zogjve; mjalti natyral; produkte te ngrenshme me origjine prej kafsheve, te paperfshira apo te paspecifikuara diku tjeter
5. Produktet me origjine prej kafsheve, te paperfshira dhe te paspecifikuara diku tjeter

Seksioni II

PRODUKTET VEGJETALE

6. Pemet dhe bimet e tjera, te gjalla; zhardhoket, rrenjet dhe te ngjashmet me to; lulet e prera dhe gjethnajat zbuturuese
7. Zarzavatet e ngrenshme, rrenjet dhe tuberat perkates

Kapitulli

8. Frutat dhe arrat e ngrenshme; lekurat e agrumeve apo te pjeprave
9. Kafe, çaj, mate dhe ereza
10. Dritherat
11. Produktet e industrise bluajtese; malt; niseshtete; inuline; gluteni i grurit
12. Farat vajore dhe frutat me permbajtje vajore; kokrra, fara dhe fruta te ndryshme; bimet industriale apo medicinale; kashta dhe tagjia
13. Lac; gomat, rreshirat, lengje dhe ekstrakte te tjera vegjetale
14. Materialet vegjetale qe perdoren per thurje; produktet vegjetate te paperfshira dhe te paspecifikuara diku tjeter.

Seksioni III

VAJRA DHE DHJAMRA PREJ KAFSHEVE APO VEGJETALE DHE PRODUKTET E NDARJES SE TYRE; YNDYRA TE PERGATITURA TE NGRENHME; DYLLET VEGJETALE APO PREJ KAFSHEVE

15. Vajra dhe dhjamra prej kafsheve apo vegjetale dhe produktet e ndarjes se tyre; yndyrna te pergatitura te ngrenshme; dyllat vegjetate apo prej kafsheve

Seksioni IV

USHQIME TE PERGATITURA; PIJET, ALKOOLET DHE UTHULLAT; DUHANET DHE ZEVENDESUESIT E PERPUNUAR TE DUHANIT

16. Ushqimet e pergatitura prej mishit, peshkut apo krustaceve, molusqeve apo kafsheve te tjera jovetebrore ujore
17. Sheqeri dhe embelsirat prej tij
18. Kakao dhe pregatitjet prej kakaos
19. Pergatitjet prej drithrave, miellit, niseshtese apo qumeshtit; produktet e pasticerise apo te brumrave
20. Pergatitje prej zarzavateve, frutave, arrave apo pjeseve te tjera te bimeve
21. Pergatitje te ndryshme te ngrenshme
22. Pijet, alkoolet dhe uthullat
23. Mbetjet dhe kthimet nga industrite ushqimore; tagjia e pergatitur per kafshet
24. Duhani dhe zevendesuesit e perpunuar te duhanit

Seksioni V

PRODUKTET MINERALE

25. Kriperat; sulfuret; oksidet dhe guret; materialet suvatuese, gelqere dhe çimento
26. Xeheroret, zgjyrat dhe hiri
27. Lendet djegese minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit te tyre; substancat bituminoze; dyllet minerale

Seksioni VI

**PRODUKTET E INDUSTRISE KIMIKE
APO TE INDUSTRIVE TE LIDHJEVE**

28. Kimikatet inorganike; perberjet organike dhe inorganike te metaleve te çmuar, te metaleve te rralle, te elementeve radioaktive apo te izotopeve
29. Kimikatet organike
30. Produktet farmaceutike
31. Pleheruesit
32. Ekstraktet ngjyrosese dhe tanike; taninet dhe derivatet e tyre; ngjyrosesit, pigmentet dhe lende te tjera ngjyrosese; bojrat dhe llustrosesit; stuko dhe mastiçet e tjera; bojrat e shkrimt
33. Vajrat thelbesore dhe rreshirat; pergatitjet e parfumerise, kozmetikes, apo te tualetit
34. Sapuni, agjentet organike me veprim te siperfaqshem, preparatet larese, preparatet lubrifikuese, dyllet artificiale, dyllet e pergatitura, preparatet llustrosese apo pastruese, qirinjte dhe artikuj te ngjashem, pastat modeluese, "dyllet dentare" dhe perparatet dentare me baze allçie
35. Substanca albuminoidale; niseshtete e modifikuara; ngjitesat; enzimat
36. Eksplozivitet; produktet piroteknike; shkrepsat; lidhjet piroforike; preparatet e cak tuara te djegshme
37. Mallrat fotografike dhe kinematografike
38. Produkte te ndryshme kimike

Seksioni VII

**PLASTIKAT DHE ARTIKUJT PREJ TYRE;
GOMA DHE ARTIKUJT PREJ SAJ**

39. Plastikak dhe artikujt prej tyre
40. Goma dhe artikujt prej gome

Seksioni VIII

**LEKURET E PAPERPUNUARA, LEKURET E
PERPUNUARA, GEZOFET DHE ARTIKUJT E TYRE;
TAKEMET DHE PAJIMET E KUAJVE (SHALA,
FRERI) ; MALLRAT E UDHETIMIT, ÇANTA DORE
DHE MBAJTES TE NGJASHEM; ARTIKUJT PREJ
ZORREVE TE KAFSHEVE (PERVEÇ FSHIKEZAVE
TE KRIMBIT TE MENDAFSHIT)**

41. Lekuret e paperpunuara (perveçe gezofeve) dhe lekuret e perpunuara
42. Artikujt prej lekure; takemet dhe pajimet e kalit; mallrat e udhetimit, çantat e dores dhe kontenierte te ngjashem; artikujt prej te brendshmeve te kafsheve (perveç fshikezave te krimbit te mendafshit)
43. Gezofet dhe qimet artificiale; prodhimet prej tyre

Seksioni IX

**DRURI DHE ARTIKUJT PREJ DRURI; QYMYRI I
DRURIT; TAPA DHE ARTIKUJT PREJ TAPE;
PRODHIMET PREJ KASHTES, PREJ ASPARTO APO
PREJ MATERIALEVE TE TJERA GERSHETUESE;
PUNET NE XUNKTH APO ME KALLAMA**

44. Druri dhe artikujt prej druri, qymyri i drurit
45. Tapa dhe artikujt prej tape
46. Prodhimet e kashtes, te aspartos apo te materialeve te tjera thures; punimet ne xunkth dhe me kallama

Seksioni X

**BRUMI I DRURIT APO I MATERIALEVE TE
TJERA FIBROZE CELULOZIKE; LETER DHE
KARTON I RICIKLUESHEM (MBETJE DHE
KTHIME); LETRA DHE KARTONI, ARTIKUJT
PREJ TYRE**

47. Brumi i drurit apo i materialeve te tjera fibroze celulozike; leter dhe karton i riciklueshem (mbetje dhe kthime)
48. Letra dhe kartoni; artikujt prej brumit te letres, prej letre apo kartoni
49. Librat, revistat, pikturat dhe produkte te tjera te industrise se shtypit; doreshkrimet; shtypshkrimet dhe projektet

Kapitulli

Seksioni XI

TEKSTILET DHE ARTIKUJT TEKSTILE

50. Mendafshi
51. Leshi, qime te holla apo te ashpra kafshesh; fije prej flokeve te kalit dhe pelhura te endura prej tyre
52. Pambuku
53. Fibra te tjera tekstile vegjetale; fill letre dhe pelhura te endura prej fijeve prej letre
54. Filamentet e bera nga njerezit; shiritat dhe te ngjashme me to te materialeve tekstile te bera nga njerezit
55. Fibrat shtapel te bera nga njerezit
56. Mbushje, shajak dhe pelhura te paendura; fijet speciale; spango, kordone, litare, kablllo dhe artikujt prej tyre
57. Qilimat dhe mbulues te tjere te dyshemese prej tekstili
58. Pelhura speciale; pelhura tekstile tufted; tantellat tapicerite; zbukurimet; qendismat
59. Pelhurat tekstile te ngopura, te veshura, te mbuluara apo te laminuara; artikujt tekstile te nje lloji te pershtatshem per perdorim industrial
60. Pelhurat e thurura me shume file apo me nje file
61. Artikuj te veshjes dhe pjese shtese per veshjet, te thurura me shume file apo nje file
62. Artikuj te veshjes dhe plotesues te veshjeve, jo te thurura me nje file apo me shume file.
63. Artikuj te tjere te bere me tekstile; kompletet; veshjet e perdorura dhe artikuj tekstile te perdorur; lecka mbeturine

Seksioni XII

VESHJET E KEMBEVE, VESHJET E KOKES, ÇADRAT, ÇADRAT E DIELLIT, BASTUNET, BASTUNET MBESHKETES, KAMZHIKET, ARTIKUJT PER GJUETI DHE PJESET PREJ TYRE; PUPLAT E PERGATITURA DHE ARTIKUJT E BERE ME TO; LULET ARTIFICIALE; ARTIKUJ TE FLOKEVE TE NJEREZVE

64. Veshjet e kembeve, galloshet dhe te ngjashmet e tyre; pjeset e artkujve te tille
65. Veshjet e kokes dhe pjeset e tyre
66. Çadrat, çadrat e diellit, bastunet, bastunet mbeshketes, kamzhiket, artikujt per gjueti dhe pjeset e tyre
67. Puplat dhe pushi i pergatitur, artikujt e bere nga puplat apo nga pushi; lulet artificiale, artikujt prej flokeve te njerezve

Kapitulli

Seksioni XIII

ARTIKUJT PREJ GURI, ALLÇIE, ÇIMENTOJE, ASBESTI, MIKE APO MATERIALE TE NGJASHME; PRODUKTET QERAMIKE; QELQI DHE PRODHIMET PREJ QELQI

68. Artikujt prej guri, allçie, çimentoje, asbesti, mike apo materiale te ngjashme
69. Produkte qeramike
70. Qelqi dhe prodhimet prej qelqi

Seksioni XIV

PERLAT NATYRALE APO TE KULTIVUARA, GURET E ÇMUAR APO GJYSEM TE ÇMUAR, METALET E ÇMUARA, METALE TE VESHUR ME METAL TE ÇMUAR DHE ARTIKUJT PREJ TYRE; IMITACIONET E BIZHUTERIVE; MONEDHAT

71. Perlat natyrale apo te kultivuara, guret e çmuar apo gjysem te çmuar, metalet e çmuara, metale te veshura me metal te çmuar dhe artikujt e tyre; imitacione te bizhuterive; monedha

Seksioni XV

METALET BAZE DHE ARTIKUJT ME METALEVE BAZE

72. Giza dhe çeliku
73. Artikujt prej gizes dhe çelikut
74. Bakri dhe artikujt prej bakri
75. Nikeli dhe artikujt prej tij
76. Alumini dhe artikujt prej tij
77. (Rezervuar per perdorime te mundshme ne te ardhmen ne Sistemin e Harmonizuar)
78. Plumbi dhe artikujt prej tij
79. Zinku dhe artikujt prej tij
80. Kallaji dhe artikujt prej tij
81. Metale te tjere baze; metaloqeramikat; produktet prej tyre
82. Veglat e punes, pajisjet e punes, takemet e ngrenies, luget dhe pirunet prej metali baze; pjeset e tyre prej metali baze
83. Artikuj te ndryshem prej metali baze

Seksioni XVI

MAKINERI DHE PAISJET MEKANIKE; PAJISJE ELEKTRIKE; PJESET E TYRE; RREGJISTRUESIT DHE RIPRODHUESIT E TINGULLIT, RREGJISTRUESIT DHE RIPRODHUESIT E IMAZHIT TELEVIZIV DHE ZERIT, PJESET DHE PLOTESUESIT E KETIRE ARTIKUJVE

84. Reaktoret nukleare, bolieret, makineri dhe paisje mekanike; pjeset e tyre
85. Makineri dhe paisje elektrike, pjeset e tyre regjistruarit dhe riprodhuesit e tingullit, regjistruarit dhe riprodhuesit e imazhit televiziv dhe zerit, pjeset dhe plotesuesit e ketire artikujve

Seksioni XVII

MJETET E TRANSPORTIT RRUGOR, AJROR, DETAR DHE PAJISJET SHOQERUESE TE TRANSPORTIT

86. Lokomotivat e trenave apo tramvajeve, vagonet dhe pjeset e tyre; fiksuesit dhe pershtatjet e shinave te hekurudhave apo tramvajeve, pjeset e tyre; pajisjet mekanike te sinjalizimit (perfshire elektro-mekanike) te te gjitha llojeve
87. Mjetet e transportit te ndryshem nga vagonet e hekurudhes ose tramvajit, pjeset dhe plotesuesit e tyre
88. Avionet, anijet e hapësirës, dhe pjeset e tyre
89. Anijet, varkat dhe strukturat lundruese

Seksioni XVIII

INSTRUMENTAT DHE APARATET OPTIKE, FOTOGRAFIKE, KINEMATOGRAFIKE, MATESE, KONTROLI, PRECIZIONI, MJEKESORE OSE KIRURGJIKALE; ORET E TE GJITHA LLOJEVE; INSTRUMENTAT MUZIKORE; PJESET DHE PLOTESUESIT E TYRE

90. Instrumentat dhe aparatet optike, fotografike, kinematografike, matese, kontrolli, precizioni, mjekesore ose kirurgjikale; pjeset dhe plotesuesit e tyre
91. Oret e te gjitha llojeve dhe pjeset e tyre
92. Instrumentat muzikore; pjeset dhe plotesuesit te artikujve te tille

Seksioni XIX

ARMET DHE MUNICIONET; PJESET DHE PLOTESUESIT E TYRE

93. Armet dhe municionet; pjeset dhe plotesuesit e tyre.

Seksioni XX

ARTIKUJ TE NDRYSEM TE PRODHUAR

94. Mobilerite; krevatet, dysheket, mbajteset e dyshekeve, jasteqet dhe shtresa te ngjashme te mbushura; llambat dhe pajime ndricimi, jo te perfshira ose specifikuara diku tjeter; shenjat ndricuese, pllakat e emrit ndricuese dhe te ngjashmet e tyre; ndertesat e parafabrikuara
95. Lodrat, pajisjet e lojrave dhe ato te sportive; pjeset dhe plotesuesit e tyre
96. Artikuj te ndryshem te prodhuar

Seksioni XXI

VEPRAT E ARTIT, COPAT E MBLEDHURA NGA KOLEKSIONISTET DHE ANTIKAT

97. Veprat e artit, copat e mbledhura nga koleksionistet dhe antikant
98. I rezervuar
99. Dispozita per klasifikime te vecanta

PJESA E TRETE – SHTOJCAT E TARIFAVE

Seksioni I

Lista e substancave farmaceutike te cilat `caktohen per trajtimet pa takse doganore

- Shtojca 1. Lista e emrave te perbashket nderkombetare (INN) dhene per substancat farmaceutike nga Organizata Boterore e Shendetit, te cilat jane pa takse doganore
- Shtojca 2. Lista e parashtesave dhe prapashtesave te cilat ne kombinim me INN-te e Shtojces 1, pershkruajne kriperat, esteret apo hidratet e INN; keto kripera, estere dhe hidrate jane pa takse, ne kushtet kur

ato janë të klasifikueshme në të njëjtën kre 6-shifror të sistemit të harmonizuar sikurse korresponduesit INN	Shtojca 4	Lista e produkteve farmaceutike të ndërmjetme, d.m.th. produktet të cilat përdoren për prodhimin e produkteve farmaceutike përfundimtare, të cilat janë pa takse doganore
Shtojca 3 Kriperat, esteret dhe hidratet e INN, të cilat nuk klasifikohen në të njëjtën kre të Sistemit të Harmonizuar si dhe emrat korrespondues INN, të cilat janë pa takse doganore.		Seksioni II
	Shtojca 5	(Rezervuar për përdorim në të ardhmen në Sistemin e Harmonizuar)
		Seksioni III
	Shtojca 6	Mallrat e përdorshme për konsum njerezor

PJESA E PARE
DISPOZITAT PARAPRAKE

SEKSION I

RREGULLAT E PERGJITHSHME

A. Rregullat e pergjithshme per interpretimin e Nomenklatures se Kombinuar

Klasifikimi ne Nomenklaturen e Kombinuar te mallrave do te udhëhiqet sipas parimeve qe pasojne:

1. Titujt e Seksioneve, Kapitujve dhe nenkapitujve jane dhene vetem per lehtesi referimi; per qellime ligjore, klasifikimi do te percaktohet ne perputhje me kushtet e krereve dhe shenimeve relative te ndonje Seksioni apo Kapitulli dhe me kusht qe te tilla krere ose Shenime nuk e kerkojne ndryshe, ne perputhje me rregullat e meposhtme:
2.
 - (a) Çdo reference ne nje kre per nje artikull do te merret sikur perfshin nje reference per ate artikull te paplotesuar apo te pambaruar, me kusht qe, ashtu siç eshte paraqitur, artikulli i pambaruar apo i paplotesuar ka karakterin thelbesor te artikullit te plotësuar apo te mbaruar. Ai gjithashtu do te merret sikur perfshin nje reference per ate artikull te plotësuar apo te mbaruar (ose qe mund te klasifikohet si i mbaruar apo i plotësuar sipas ketij rregulli), por i paraqitur te pamontuara apo te ndara.
 - (b) Çdo reference ne nje kre per nje material apo substance do te merret sikur perfshin nje reference per perzierjet apo kombinimet e atij materiali apo substance me materiale apo substanca te tjera. Çdo reference per mallrat e atij materiali apo substance te dhene, do te merret sikur perfshin nje reference per mallrat e perbera teresisht apo pjeserisht prej materialeve apo substancave te tilla. Klasifikimi i mallrave te perbera nga me shume se nje material apo substance do te behet ne perputhje me parimet e Rregullit (3).
3. Kur nga zbatimi i rregullit 2 (b) ose per ndonje arsye tjeter, mallrat jane, ne pamje te pare, te klasifikueshme ne dy apo me shume krere, klasifikimi do te ndikohet nga kriteret e meposhteme:
 - (a) kreu i cili jep pershkrimin me specifik do te preferohet nga kreret qe japin nje pershkrim me te pergjithshem. Megjithate, kur dy apo me shume krere secili i referohet vetem pjeses se materialeve apo substancave qe bejne pjese ne mallrat e perbere apo te perziera, apo vetem pjeses se artikujve ne nje grup te vendosur per shitjen me pakice, keto krere do te vleresohen njelloj te specifikuar ne lidhje me keto mallra, edhe nese njeri prej tyre jep nje pershkrim me te sakte apo me te plote te mallrave.
 - (b) mallrat e perbera dhe perzierjet qe perbehen nga materiale apo komponente te ndryshem dhe mallrat e vendosura ne nje grup per shitjen me pakice, te cilat nuk mund te klasifikohen sipas rregullit 3 (a) do te klasifikohen sikur perbehen nga materialet apo komponenti qe i jep atyre karakterin thelbesor, aq sa eshte e mundur te zbatohet ky kriter.
 - (c) kur mallrat nuk mund te klasifikohen sipas rregullave 3(a) apo 3(b), ato do te klasifikohen ne kreun i cili ndodhet i fundit ne rendin numerik, midis atyre mallrave qe meritojne te njejtin vleresim.
4. Mallrat qe nuk mund te klasifikohen sipas rregullave te mesiperme do te klasifikohen ne kreret me te pershtatshem, me mallrat me te cilat ato jane te ngjashme.
5. Ne shtese te rregullave te mesiperme, rregullat e meposhtme do te zbatohen ne perputhje me mallrat qe permbajne:
 - (a) Kutite e kamerave, kutite e instrumenteve muzikore, kutite e armeve, kutite e veglave te pikturës, kutite e bizhuterive dhe kontenieret e ngjashem veçanerisht te pershtatur per te futur nje artikull apo grup artikujsh te veçante, te pershtatshem per perdorim afatgjate dhe te paraqitura se bashku me artikujt per te cilet ato jane bere, do te klasifikohen me keto artikuj, ne rast se sipas llojit te tyre shiten normalisht bashke me to. Megjithate, ky rregull nuk zbatohet per kontenieret te cilet i japin te teres karakterin e saj thelbesor.
 - (b) Sipas rregullit 5(a), materialet paketuese dhe kontenieret paketues⁽¹⁾ te paraqitur bashke me mallrat brenda do te klasifikohen me keto mallra, nese ato jane te nje lloji te cilet normalisht perdoren per paketimin e te tilla mallrave. Por kjo klauzole nuk eshte e detyrueshme kur te tilla materiale paketuese apo konteniere jane qartesisht te pershtatshem per riperdorim.
6. Per qellime ligjore, klasifikimi i mallrave ne nenkreret e nje kreu, do te percaktohet ne perputhje me kushtet e ketyre nenkrereve dhe te ndonje Shenimi relativ te nenkrerut, *mutatis mutandis*, sipas rregullave te mesiperme, me kuptimin se

(1) Termi 'material paketues' dhe 'kontenier paketues' do te thote kontenier te jashtem apo te brendshem, mbajtes, mbeshthjelles apo mbeshthetes ndryshe nga pajisjet e transportit (p.sh. kontenier transporti), pelhure e gomuar/leter kratama, mjet ngritjeje apo pajisje ndihmese transporti. Termi kontenier paketues nuk perfshin kontenieret referuar rregullit 5 (a).

vetem nenkreret e te njejt nivel jane te krahasueshem. Per qellimet e ketij rregulli, shenimet relative te Seksioneve dhe Kapitujve zbatohen gjithashtu, pervec kur konteksti e kerkon ndryshe.

SEKSIONI II

DISPOZITA SPECIALE

A. Mallrat per kategori te caktuara te anijeve, vaporeve dhe mjeteve te tjera lundruese dhe per platformat shpuese apo te prodhimit.

1. Taksat doganore pezullohen per mallrat qe jane te destinuara per tu trapezuar ne anije, vapore apo mjete te tjera lundruese te listuar ne listen me poshte, per qellime te ndertimit, riparimit, mirembajtjes apo konvertimit, dhe per mallrat qe jane te destinuara per te pershtatur apo pajisur te tilla anije, vapore apo mjete te tjera lundruese.

2. Taksat doganore pezullohen per :

(a) mallrat te destinuara per tu trapezuar ne platformat shpuese apo te prodhimit :

1. te fiksuar, nenkreu ex 8430 49 qe operojne ne apo jashte urave territoriale te Republikes se Shqiperise, apo

2. lundruese apo zhytесе, nenkreu 8905 20,

per qellime te ndertimit, riparimit, mirembajtjes apo kembimit dhe per sa i perket mallrave te destinuara per pajisjen e platformave ne fjale.

Mallra te tilla si lende djegese te motoreve, lubrifikante dhe gaz, qe jane te domosdoshem per funksionimin e makinerive dhe aparaturave te cilat nuk ndikojne ne menyre te perhershme dhe nuk jane pjese integrale e platformave dhe perdoren ne bord per ndertim, riparim, mirembajtje, kembim apo pajisje te ketyre platformave, gjithashtu vleresohen sikur perdoren ne platformat shpuese apo te prodhimit;

(b) tubat, tubacionet, kabllo dhe pjeset lidhese te tyre, qe lidhin keto platforma shpuese apo prodhuese me token.

Kodi	Pershkrimi
8901	Mjete lundruese, varkat e ekskursionit, anijet e kargos, tragetet, varkat me motor dhe te ngjashme per transportin e personave apo mallrave :
8901 10	- Mjetet lundruese, varkat e ekskursionit dhe anijet e ngjashme kryesisht te projektuara per transportin e personave; tragetet e te gjitha llojeve :
8901 10 10	- - Anije lundrimi
8901 20	- Cisternat :
8901 20 10	- - Anije lundrimi
8901 30	- Anijet frigorifer, te ndryshme nga ato te nenkreut 8901 20 :
8901 30 10	- - Anije lundrimi
8901 90	- Anijet e tjera per transportin e mallrave dhe anije te tjera per transport te njerezve dhe mallrave :
8901 90 10	- - Anije lundrimi
8902 00	Anijet e peshkimit; vaporet fabrike dhe anije te tjera per perpunimin apo ruajtjen e produkteve te peshkimit :
8902 00 10	- Anije lundrimi
8903	Jahtet dhe mjete te tjera ujore per kenaqesi dhe sporte; varkat vozitese dhe kanoet :
	- Te tjera:
8903 91	- - Varkat me vela, me ose pa motor ndihmes :

8903 91 10	- - - Anije lundrimi
8903 92	- - Varkat me motor, te ndryshme nga varkat me motor jashte bordit :
8903 92 10	- - - Anije lundrimi
8904 00	Anije rimorkiator dhe anije shtytese:
8904 00 10	- Anijet rimorkiator
	- Anijet shtytese :
8904 00 91	- - Anije lundrimi
8905	Mjete ujore ndriçuese, zjarrfikese, gerryese, vinçat notues dhe mjete te tjera, lundrimi i te cilave eshte ndihmes i funksionit kryesor te tyre; skelat lundruese; platformat lundruese ose platformat e shpimit apo platformat e prodhimit:
8905 10	- Geryesit :
8905 10 10	- - Anije lundrimi
8905 90	- Te tjera :
8905 90 10	- - Anije lundrimi
8906	Mjete te tjera ujore, perfshi luftanijet dhe lundrat e shpetimit te ndryshme nga varkat vozitese :
8906 10 00	- Luftanijet
	- Te tjera :
8906 90 10	- - Anije lundrimi

3. Pezullimi i nenshtrohet kushteve te percaktuara ne udhezimin perkates mbi proceduren e kontrollit doganor per perdorimin e ketyre mallrave.

B. Avionet civil dhe mallrat per perdorim ne aviacionin civil

1. Perjashtimi nga taksat doganore jepet per :

- avionet civil;
- mallra te caktuara per perdorim ne aviacionin civil dhe per tu trupezuar ne to gjate procesit te prodhimit, riparimit, mirembajtjes, rindertimit, modifikimit apo kembimit;
- avionet simulues per trajnim pilotesh dhe pjeset e tyre, per perdorim ne aviacionin civil.

Keto mallra mbulohen prej krereve dhe nenkrereve te renditur ne tabelen e paragrafit 5.

2. Per qellime te paragrafit 1, nendarja e pare dhe dyte, "avione civil" do te thote avione ndryshe nga avionet e perdorur ne ushtri ose sherbime te ngjashme ne Republiken e Shqiperise qe kryejne nje regjistrim ushtarak apo jo-civil.
3. Per qellime te paragrafit 1, nendarja e dyte, shprehja "per perdorim ne avione civil" do te perfshije mallrat per perdorim ne avionet simulues per trajnim pilotesh per perdorim civil.
4. Perjashtimi nga detyrimet doganore do t'i nenshtrohet kushteve te vendosura ne ligjin nr.102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", Neni 227

Megjithatë, këto kushte nuk do të zbatohen në rastet kur avionët civilë që përfshihen në nënkrerët 8802 11, 8802 12, 8802 20, 8802 30, 8802 40 janë regjistruar në regjistrin e një Shteti Anëtar ose të një vendi të tretë në pajtim me Konventën Aviacioni Civil Ndërkombëtar i datës 7 dhjetor 1944 dhe referenca është bërë në deklaratën doganore për lëshim në qarkullim të lirë në certifikatën përkatëse të regjistrimit.

5. Mallrat qe i nenshtrohen perjashtimit nga detyrimet doganore mbulohen prej krereve apo nenkrereve te meposhtem:

3917 40, 4011 30, 4012 13, 4012 20, 6812 99, 7324 10, 7326 20, 8302 10, 8302 20, 8302 42, 8302 49, 8302 60, 8407 10, 8408 90, 8409 10, 8411, 8412 10, 8412 21, 8412 29, 8412 31, 8412 39, 8412 80 80, 8412 90, 8413 19, 8413 20, 8413 30, 8413 50, 8413 60, 8413 70, 8413 81, 8413 91, 8414 10, 8414 20, 8414 30, 8414 51, 8414 59, 8414 80, 8414 90, 8415 81, 8415 82, 8415 83, 8418 10, 8418 30, 8418 40, 8418 61, 8418 69, 8419 50, 8419 81,

8421 19, 8421 21, 8421 23, 8421 29, 8421 31, 8421 39, 8424 10, 8479 90, 8483 10, 8483 30, 8483 40, 8483 50, 8483 60, 8483 90, 8484 10, 8484 90, 8501 32, 8501 52, 8501 61, 8501 62, 8501 63, 8502, 8504 10, 8504 31, 8504 32, 8504 33, 8504 40, 8504 50, 8507, 8511 10, 8511 20, 8511 30, 8511 40, 8511 50, 8511 80, 8518 10, 8518 22, 8518 29, 8518 30, 8518 40, 8518 50, 8519 81 95, 8521 10, 8526, 8528 52, 8529 10, 8531 10 95, 8531 20, 8531 80, 8539 10, 8544 30, 8801, 8802 11, 8802 12, 8802 20, 8802 30, 8802 40, 8803 10, 8803 20, 8803 30, 9001 90, 9002 90, 9014 10, 9025, 9029 20 38, 9030 31, 9030 33, 9030 89, 9032, 9104.

Ne nenkreret e meposhtem, perjashtimi nga detyrimet doganore i mallrave per perdorim ne aviacionin civil jepet vetem per mallrat e pershkruara ne kolonen e dyte:

Nenkreu	Pershkrimi
3917 21 90, 3917 22 90, 3917 23 90, 3917 29 00, 3917 31, 3917 33, 3917 39 00, 7413 00, 8307 10, 8307 90	Me pershtates bashkangjitur
4008 29	Forma profile, te prera ne mase
4009 12, 4009 22, 4009 32, 4009 42	Te pershtatshme percjelljen e gazeve apo lengjeve.
3926 90, 4016 10, 4016 93 4016 99	Per perdorime teknike
4504 90	Rondele, guarnicionet dhe bashkues te tjere.
6812 80	Te tjera veç veshjeve, paisjeve shtese te veshjeve, veshjeve te kembes, kapele, leteres, kartonit te trashe, shajakut ose bashkuesit e presuar te fibrave te asbestit, ne flete apo role.
6813 20, 6813 81, 6813 89	Me baze asbesti apo substancave te tjera minerale
7007 21	Xham mbrojtës, pa kornize
7322 90	Ngrohes te ajrit dhe shperndaresit e ajrit te ngrohte (perjashtuar pjeset)
7324 90	Artikuj sanitarë (perjashtuar pjeset e tyre)
7608 10, 7608 20	Me pershtates bashkangjitur, te pershtatshme per percjelljen e gazeve ose te lengjeve.
8108 90	Tuba dhe tubacione, me pershtates bashkangjitur, te pershtatshme per percjelljen e lengjeve ose te gazeve.
8415 90	Te kondicionereve te nenkreteve 8415 81, 8415 82 ose 8415 83
8419 90	Pjeset e njesive te kembimit te nxehtesise

Nenkreu	Pershkrimi
8479 89	Baterite hidropneumatike; aktuatoret mekanike per ndryshimin e goditjeve; njesite e tualetit te percaktuara ne menyre specifike; lageshtuesit e ajrit dhe heqesit e lageshtise; mekanizem ndihmes, jo-elektrik; motoret starter jo-elektrik; starterat pneumatik per motoret turboreaktive, turbohelike dhe turbina te tjera gazi; fshireset e xhamave mbrojtjes, jo-elektrike; rregullatoret e helikave, jo-elektrike.
8501 20, 8501 40	Te nje fuqie me teper se 735 W por jo me teper se 150 kW
8501 31	Te nje fuqie me teper se 735 W, gjeneratoret DC
8501 33	Motoret te nje fuqie jo me teper se 150 kW dhe gjeneratoret
8501 34	Gjeneratoret te nje fuqie me teper se 375 W
8501 51	Te nje fuqie me teper se 735 W
8501 53	Te nje fuqie jo me teper se 150 kW
8516 80 20	Montuar vetem me nje lidhje elektrike te meparshme thjesht te izoluar, perdorur per antingirje ose shkrirje.
8522 90	Montime dhe nenmontime qe konsistojne ne dy apo me teper pjese ose cope te fiksuara apo te lidhura se bashku, per aparaturat e nenkreut 8519 81 95 dhe 8519 89 90.
8529 90	Montime dhe nenmontime qe konsistojne ne dy apo me teper pjese ose cope te fiksuara apo te lidhura se bashku, per aparaturat e kreut 8526.
8536 70	Lidhesa plastike per fibra optike, dengje te fibrave optike ose kablo.
8543 70 90	Regjistruarit e fluturimeve, sinkronet dhe perkthyesit elektrike, pajisjet shkrirje dhe demisters me rezistence elektrike.
8803 90 90	Perfshire avionet pa motor
9020 00	Perjashtuar pjeset
9029 10	Numeruesit elektrik apo elektronik te rrotullimit.
9029 90	Prej numeruesve te rrotullimit, treguesve te shpejtesise dhe takometrave.

Enkreu	Pershkrimi
9109 10, 9109 90	Te nje gjerësie apo diametri jo me teper se 50 mm
9405 10, 9405 60	Prej plastikave apo prej metali baze
9405 92, 9405 99	Prej artikujve te nenkreve 9405 10 apo 9405 60, prej plastikave apo prej metali baze

C. Produktet farmaceutike

1. Perjashtimi nga detyrimet doganore parashikohet per produktet farmaceutike te kategorive te meposhtme :

- (1) substancat farmaceutike te cilat mbulohen prej CAS RN (numri kimik abstrakt i sherbimit te regjistrimit) dhe emri i perbashket nderkombetar (INN) listuar ne Aneksin 3;
- (2) kriperat, esteret dhe hidratet e INN te cilat jane te pershkuara nepermjet kombinimit te INN te Aneksit 3 me parashtesat dhe prapashtesat e Aneksit 4, po qe se produkte te tilla te klasifikohen ne te njeitin nenkre 6 – shifror te HS sikurse dhe INN korresponduese ;
- (3) kriperat, esteret dhe hidratet e INN, te cilat jane te listuara ne Aneksin 5 dhe te cilat nuk klasifikohen ne te njeitin nenkre 6 – shifror te HS sikurse dhe INN koresponduese ;
- (4) produktet e ndermjetme farmaceutike, p.sh. perberjet te nje lloji te perdorura ne prodhimin e produkteve perfundimtare te cilat mbulohen prej CAS RN dhe emrave kimik, te listuara ne Aneksin 6.

2. Raste te veçanta :

- (1) INN mbulon vetem ato substanca te pershkuara ne listat e publikimeve INN, te rekomanduara dhe propozuara prej Organizates Boterore e Shendetesise (WHO). Kur numri i substancave te mbuluara prej nje INN eshte me i vogel se ai i mbuluar prej CAS RN, vetem ato substanca te mbuluara prej INN do te jene objekt i trajtimit pa takse doganore ;
- (2) Kur nje produkt i Aneksit 3 apo i Aneksit 6, identifikohet nga CAS RN korresponduese si nje izomer specifik, vetem ky izomer mund te trajtohet pa takse doganore;
- (3) Derivatet e dyfishta (kriperat, esteret dhe hidratet) te INN, te identifikuara nga nje kombinim i INN se Aneksit 3 me parashtesen apo prapashtesen e Aneksit 4, trajtohen pa takse doganore, nese ato te klasifikohen ne te njeitin nenkre 6-shifrore sikurse dhe INN koresponduese :

Shembull : alanine metil ester, hidrokloride ;

- (4) kur nje INN e Aneksit 3 eshte nje kripe (apo nje ester), asnje kripe tjeter (apo ester) e acidit koresponues INN nuk mund te trajtohet pa takse doganore :

shembull : oxprenolate kaliumi (INN): pa takse doganore
oxprenolate natriumi : me takse doganore

D. Kontenieret dhe materialet paketuese

Kur kontenieret dhe materialet paketuese te perfshire nga rregullat e paragrafit 1 (a) dhe (b) permbajne apo jane te paraqitura me mallra me pershkrime te ndryshme tarifore, vlera e konteniereve dhe materialeve paketuese, per qellime te percaktimit te vleres se tyre te taksueshme, duhet te ndahent proporcionalisht midis mallrave qe permbajne, ne raport me vleren e ketyre mallrave.

E. Trajtimi tarifar favorizues per shkak te natyres se mallrave ose te perdorimit te tyre te veçante

1. Me plotesimin e disa kushteve, trajtimi tarifar favorizues per shkak te natyres se mallrave ose te perdorimit te tyre te veçante, eshte i mundur per mallrat qe perfshihen ne nenkreret 0101 21 00; 0102 21 10; 0102 21 30; 0102 21

90; 0102 29 29; 0102 31 00; 0102 39 10; 0102 90 20; 0102 90 91; 0206 29 10; 0206 10 10; 0206 8010; 0206 90 10; 0407 11 00; 0407 19 11; 0407 19 19; 0701 10 00; 0713 10 10; 0713 33 10; 1501 10 10; 1501 20 10; 1502 10 10; 1502 90 10; 1503 00 11; 1508 10 10; 1508 90 10; 2501 00 51; 2701 12 10; 2710 12 11; 2710 12 15; 2710 19 11; 2710 19 15; 2710 19 71; 2710 19 75; 2710 19 93; 2712 90 31; 2712 90 33.

Secili nga nenkreret e mesiperm permban shenimin ne fund te faqes: "Klasifikimi ne kete Kod i nenshtrohet kushteve te Nenit 28 te K.D. dhe pikave 169 deri 179 te D.Z."

2. Mallrat e papershtatshem per konsum per te cilat trajtimi tarifar favorizues eshte dhene per arsye te natyres se tyre, jane listuar ne shtojcen 4, referuar kreut nen te cilin ato jane klasifikuar se bashku me pershkrimin dhe sasite e dentyruesve te perdorur. Mallra te tille konsiderohen te papershtatshem per konsum kur mallrat per tu denatyrar dhe denatyruesit jane nje perzjerje homogjene dhe ndarja eshte ekonomikisht e pazbatueshme.

SHENJAT, SHKURTIMET DHE SIMBOLET

★	I referohet nje kodi te ri
■	I referohet kodeve te perdorura vitin e meparshem por me nje mbulim tjeter
AD F/M	Takse shtese per miellin
AD S/Z	Takse shtese per sheqerin
b/f	Shishe te vogla
cm/s	Centimetra per sekonde
EA	Komponent bujqesor
€	Euro
INN	Emer nderkombetar jo-tregtar
INNM	Emer nderkombetar i modifikuar jo-tregtar
ISO	Organizata nderkombetare per standardizim
Kbit	1 024 bits
kg/br	Kilogram, bruto
Kg/net	Kilogram, neto
kg/net eda	Kilogram ne peshe neto te thare
100 kg/net mase	100 kilogram, lende e thate neto
MAX	Maksimum
Mbit	1048 576 bit
MIN	Minimum
ml/g	Mililiter(a) per gram
mm/s	Milimeter(a) per sekonde
RON	Numri i kerkuar i oktanit

Shenim:

Nje numer kreu, i vendosur midis kllapave katrore ne kolonen 1 te listes se taksave doganore, tregon se ai kre eshte fshire (per shembull, kreu [1519]).

NJESITE SUPLEMENTARE

c/k	Numri i Karateve (1 karat metrik = 2×10^{-4} kg)
ce/el	Numri i elementeve
ct/l	Kapaciteti mbajtes i dobishem ne tone ⁽¹⁾
g	Gram
gi F/S	Gram te izotopeve fissile
Kg H ₂ O ₂	Kilogram i peroksidit te hidrogjenit
Kg K ₂ O	Kilogram i oksidit te kaliumit
Kg KOH	Kilogram i hidroksidit te kaliumit (potase kaustike)
Kg met.am	Kilogram te metilamines
Kg N	Kilogram te azotit
Kg NaOH	Kilogram te hidroksidit te natriumit (soda kaustike)
Kg/net eda	Kilogram te peshes neto te thate
Kg P ₂ O ₅	Kilogram te pentaoksidit te difosforit
Kg 90% sdt	Kilogram te substances 90 % te thate
Kg U	Kilogram te uraniumit
1000 kWh	1000 kilovat ore
l	Liter
1000 l	1000 litra
1 alc. 100 %	liter ne alkool te paster (100%)
m	Meter
m ²	Meter katror
m ³	Meter kub
1000 m ³	1000 meter kub
pa	Numer palesh
p/st	Numer artikujsh (krere, kokrra, cope lule/ bime/ peme etj.)
100 p/st	Njeqind artikuj
1000 p/st	Njemije artikuj
TJ	Tera-xhaul (vlere kalorike bruto)
—	Pa njesi suplementare

⁽¹⁾ 'Kapaciteti mbajtes i dobishem ne ton' (ct/l) do te thote kapaciteti mbajtes i mjeteve te lundrimt i shprehur ne ton, pa perfshire rezervat ne depot e anijeve (karburant, pajisje, furnizime ushqimore, etj.). Personat qe jane ne bord (ekupazhi dhe pasagjeret) dhe bagazhet e tyre jane te perjashtuara.

PJESA E DYTE
LISTA E TAKSAVE DOGANORE

SEKSIONI I
KAFSHET E GJALLA; PRODUKTET ME ORIGJINE PREJ KAFSHEVE

Shenime

1. Çdo reference në këtë Seksion për një specie apo lloj të veçantë kafshe, përveç kur konteksti e kërkon ndryshe, përfshin referencën e asaj specie apo kafshe në moshe të re.
2. Veçse kur konteksti e kërkon ndryshe, gjatë gjithë Nomenklaturës çdo reference për produktet e “t hara” përfshin gjithashtu produktet që janë të dehidratuar, të avulluara apo të thara në ngricë.

KAPITULLI 1
KAFSHET E GJALLA

Shenim

1. Ky Kapitull përfshin të gjitha kafshet e gjalla, përveç:
 - (a) Peshkut dhe kafsheve guaskore që jetojnë nën ujë, molusqeve dhe kafsheve të tjera jo vertebrorë ujorë, të kreut 0301, 0306, 0307 apo 0308;
 - (b) Kulturave e mikro-organizmave dhe produkteve të tjera të kreut 3002; dhe
 - (c) Kafsheve të kreut 9508.

Kodi NK	Pershkrimi	Tarifa (%)	Njesia
1	2	3	4
0101	Kuaj, gomere dhe mushka të gjalla:		
	– Kuajt		
0101 21 00	– – Te races së paster për riprodhim *	2	p/st
0101 29	– – Te tjera		
0101 29 10	– – – Per therje	10	p/st
0101 29 90	– – – Te tjera	10	p/st
0101 30 00	– Gomere	10 ⁽¹⁾	p/st
0101 90 00	– Te tjera	10	p/st
0102	Gjedhe të gjalla:		
	– Gjedhe:		
0102 21	– – Te races së paster për riprodhim:		
0102 21 10	– – – Meshqerra (gjedhet femra që nuk kanë pjelle) *	2	p/st
0102 21 30	– – – Lopet *	2	p/st
0102 21 90	– – – Te tjera *	2	p/st
0102 29	– – Te tjera:		
0102 29 05	– – – Te nenllojit <i>Bibos</i> apo te nenllojit <i>Poephagus</i>	10	p/st
	– – – Te tjera		
0102 29 10	– – – Me peshe jo më shumë se 80 kg	10	p/st

* “Klasifikimi në këtë nënkrah të nënshtrimit kushteve të nenit 56, pika 2 të Kodit Doganor dhe neneve 84 deri 91 të VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”.

⁽¹⁾Klasifikimi në kodin 0101 30 00 nëse është racë e paster për i nënshtrimit kushteve të nenit 56, pika 2 të Kodit Doganor dhe neneve 84 deri 91 të VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 dhe tarifa është 2%.

Kodi NK	Pershkrimi	Tarifa (%)	Njesia
1	2	3	4
	----- Me peshe me shume se 80 kg por jo me shume se 160 kg:		
0102 29 21	----- Per therje	10	p/st
0102 29 29	----- Te tjera *	Pa takse	p/st
	----- Me peshe me shume se 160 kg por jo me shume se 300 kg:		
0102 29 41	----- Per therje	10	p/st
0102 29 49	----- Te tjera	10	p/st
	----- Me peshe me shume se 300 kg:		
	----- Meshqerra (gjedhet femra qe nuk kane pjelle):		
0102 29 51	----- Per therje	10	p/st
0102 29 59	----- Te tjera	10	p/st
	----- Lopet:		
0102 29 61	----- Per therje	10	p/st
0102 29 69	----- Te tjera	10	p/st
	----- Te tjera:		
0102 29 91	----- Per therje	10	p/st
0102 29 99	----- Te tjera	10	p/st
	----- Bual:		
0102 31 00	----- Te races se paster per riprodhim *	2	p/st
0102 39	----- Te tjera:		
0102 39 10	----- Te llojit shtepiak.....	10	p/st
0102 39 90	----- Te tjera	10	p/st
0102 90	----- Te tjera:		
0102 90 20	----- Te races se paster per riprodhim *.....	2	p/st
	----- Te tjera		
0102 90 91	----- Te llojit shtepiak.....	10	p/st
0102 90 99	----- Te tjera	10	p/st
0103	Derra te gjalle:		
0103 10 00	----- Kafshe te races se paster	2	p/st
	----- Te tjera:		
0103 91	----- Qe peshojne me pak se 50 kg:		
0103 91 10	----- Te llojit shtepiak	2 ⁽¹⁾	p/st
0103 91 90	----- Te tjera	2	p/st
0103 92	----- Qe peshojne 50 kg ose me shume:		
	----- Te llojit shtepiak:		
0103 92 11	----- Dosa qe kane pjelle te pakten nje here, te nje peshe jo me pak se 160 kg	2	p/st
0103 92 19	----- Te tjera	2	p/st
0103 92 90	----- Te tjera	2	p/st
0104	Dele dhe dhi te gjalla:		
0104 10	----- Dele:		
0104 10 10	----- Te races se paster per riprodhim.....	2	p/st
	----- Te tjera:		
0104 10 30	----- Qingja (deri ne nje vjec)	2	p/st
0104 10 80	----- Te tjera	2	p/st

* "Klasifikimi në këtë nënkre i nënshtrohet kushteve të nenit 56, pika 2 të Kodit Doganor dhe neneve 84 deri 91 të VKM Nr. 651, datë 10.11.2017 "Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë".

⁽¹⁾ Derrat me nje peshe nen 30 kg jane me tarife 0%

Kodi NK	Pershkrimi	Tarifa (%)	Njesia
1	2	3	4
0104 20	– Dhi:		
0104 20 10	– – Te races se paster per riprodhim.....	2	p/st
0104 20 90	– – Te tjera	2	p/st
0105	Shpende te gjalle, domethene, shpendet e llojit Gallus domesticus, rosa, pata, gjela deti dhe shpende indie: – Me peshe jo me shume se 185 g:		
0105 11	– – Shpende te llojit Gallus domesticus: – – – Zogj femra per seleksionim dhe riprodhim:		
0105 11 11	– – – – Te races per veze.....	Pa takse	p/st
0105 11 19	– – – – Te tjera	Pa takse	p/st
	– – – Te tjera:		
0105 11 91	– – – – Te races per veze.....	2	p/st
0105 11 99	– – – – Te tjera	2	p/st
0105 12 00	– – Gjela dhe pula deti	Pa takse	p/st
0105 13 00	– – Rosa	Pa takse	p/st
0105 14 00	– – Pata.....	Pa takse	p/st
0105 15 00	– – Guinea fowl	Pa takse	p/st
	– Te tjera:		
0105 94 00	– – Shpende te llojit Gallus domesticus	2	p/st
0105 99	– – Te tjera:		
0105 99 10	– – – Rosa	15	p/st
0105 99 20	– – – Pata	15	p/st
0105 99 30	– – – Gjela dhe pula deti	15	p/st
0105 99 50	– – – Pule afrikane Guinea fowls	15	p/st
0106	Te tjera kafshe te gjalla:		
	– Gjitare:		
0106 11 00	– – Primatet	2	p/st
0106 12 00	– – Balenat, delfinet dhe derrat e detit (gjitare te llojit cetacea); lopet e detit (gjitare te llojit sirenia), fokat, luanet e deti, walruses (gjitare te llojit pinnipedia)	2	p/st
0106 13 00	– – Devete dhe gamilet (Camelidae)	2	p/st
0106 14	– – Lepujt:		
0106 14 10	– – – Lepujt shtepiak.....	2	p/st
0106 14 90	– – – Te tjera	2	—
0106 19 00	– – Te tjera.....	2	—
0106 20 00	– Zvarraniket (perfshire gjarperinjte dhe breshkat detare)	2	p/st
	– Shpendet:		
0106 31 00	– – Shpendet grabitqare	2	p/st
0106 32 00	– – Psittaciformes (duke perfshire papagallet, papagall trupvogel, macaws dhe cockatoos)	2	p/st
0106 33 00	– – Strucat; emus (Dromaius novaehollandiae)	2	p/st
0106 39	– – Te tjera:		
0106 39 10	– – – Pellumbat	2	p/st
0106 39 80	– – – Te tjera	2	—
	– Insektet		
0106 41 00	– – Bletet	2	—

Kodi NK	Pershkrimi	Tarifa (%)	Njesia
1	2	3	4
0106 49 00	-- Te tjera.....	2	—
0106 90 00	– Te tjera.....	2	—

KAPITULLI 2

MISHI DHE TE BRENDSHMET E NGRENSHME TE MISHIT

Shenim

1. Ky Kapitull nuk përfshin:

- (a) Produktet e llojeve të pershkruar në krerët 0201 deri 0208 apo 0210, të papershtatshme për konsum njerezor;
- (b) Zorret, fshikezat apo stomaket e kafsheve (kreu 0504) apo gjaku i kafsheve (kreu 0511 apo 3002); apo
- (c) Dhjamin prej kafsheve, përveç produkteve të kreut 0209 (Kapitulli 15).

Shenime shtese

1. A Shprehjet e mëposhtme kanë kuptimet sipas përcaktimeve për to këtu :

- (a) “trupa të gjedheve”, për qellimet e nenkrereve 0201 10 dhe 0202 10: trupa të plote të kafsheve për therje, pasi u është kulluar gjaku, hequr organet e brendshme dhe rrjepur, të importuara me apo pa koka, me apo pa kembet dhe me apo pa të brendshme të bashkangjitura. Kur trupi importohet pa koka, kjo e fundit duhet të jetë e ndarë nga trupi në pikën e bashkimit atloido-occipital. Kur importohet pa kembe, këto të fundit duhet të jenë prerë tek pika e bashkimit carpo-metacarpal apo tarso-metatarsal; “trupi” përfshin pjesën e perparme të saj të përbërë nga të gjitha kockat dhe zverkun, qafën dhe shpatullat të këne me shumë se 10 pale brinjë
- (b) “gjysme trup i gjedheve”, për qellime të nenkrereve 0201 10 dhe 0202 10, produkt i rezultuar nga ndarja simetrike e të tërë trupit nëpërmjet qendrës së çdo vertebre cervikale, dorsale, lumbare dhe sakrale dhe nëpërmjet qendrës së gjoksit dhe të symphysis ischio-pubic; “gjysme trupi” përfshin pjesën e perparme të tij të përbërë nga të gjitha kockat dhe zverkun, qafën dhe shpatullat të këne me shumë se 10 brinjë.

- (c) “çereke të kompensuar”, për qellimet e nenkrereve 0201 20 20 dhe 0202 20 10 : porcione të perbera nga njëra prej :

- çereket e perparme të perbera nga të gjitha kockat dhe zverkun, qafën dhe shpatullat, dhe të prera në hallkezen e dhjetë; çereku i pasme i përbërë nga të gjitha kockat dhe kofshen dhe sirloin, dhe të prera në hallkezen e trete, ose
- çereket e perparme të perbera nga të gjitha kockat dhe zverkun, qafën dhe shpatullat, dhe të prera në hallkezen e peste, me gjoksin dhe brinjët të bashkangjitura; çereku i pasme i perberë nga të gjitha kockat dhe nga kofsha dhe sirloin, dhe të prera në hallkezen e tete.

Çereket e perparme dhe të pasme që përbejnë “çereket e kompensuar” duhet të paraqiten në doganë në të njëjtën kohë dhe në numër të barabartë, dhe pesha totale e çerekeve të perparme duhet të jetë e barabartë me atë të atyre të pasme; megjithatë, mund të lejohet një diferencë midis peshës së dy pjesëve të ngarkesës, me kusht që ai nuk e kalon 5% të peshës të pjesës me të rëndë (çerek e perparme apo të pasme);

- (d) “çereket e perparme të pandarë”, për qellimet e nenkrereve 0201 20 30 dhe 0202 20 30: pjesa e perparme e një trupi të përbërë nga të gjitha kockat dhe zverku, qafa dhe shpatullat, me një minimum prej katër pale brinjësh dhe një maksimum prej 10 pale brinjë (katër pjesët e para të hallkave duhet të jenë të plota, të tjerat mund të jenë të prera) me apo pa brinjët e holla;
- (e) “çereket e perparme të ndarë”, për qellimet e nenkrereve 0201 20 30 dhe 0202 20 30: pjesa e perparme e një gjysme trupi të përbërë nga të gjitha kockat dhe zverku, qafa dhe shpatullat, me një minimum prej katër pale brinjë dhe një maksimum prej 10 pale brinjë (katër brinjët e para duhet të jenë të plota, të tjerat mund të jenë të prera) me apo pa brinjët e holla;
- (f) “çereket e pasme të pandarë”, për qellimet e nenkrereve 0201 20 50 dhe 0202 20 50: pjesa e pasme e një trupi të përbërë nga të gjitha kockat dhe kofshët dhe sirloin, duke përfshirë filetën, me një minimum prej tre pale brinjë të plota apo të prera, me apo pa kercinjte dhe me apo pa brinjët e holla;
- (g) “çereke të pasme të ndarë” për qellimet e nenkrereve 0201 20 50 dhe 0202 20 50: pjesa e pasme e një gjysme trupi të përbërë nga të gjitha kockat dhe kofsha dhe sirloin, duke përfshirë filetën, me një minimum prej tre pale brinjësh të plota apo të prera, me apo pa kercinjte dhe me apo pa brinjët e holla;

- (h) 1. “prerje te qafes” dhe “prerje te gurmazit dhe prerje te holla”, per qellimet e nenkrereve 0202 30 50: pjesa dorsal e çerekut te perparme, duke perfshire pjesen me te larte te shpatullave, fituar nga nje çerek i perparme me nje minimum prej kater brinje nga nje prerje pergjate nje vije te drejte nepermjet pikes ku hallkeza e pare bashkohet me segmentin e pare sternal deri tek pika e reflektimit te nje diafragme mbi brinjen e dhjete;
2. “prerje te gjoksit”, per qellimet e nenkrereve 0202 30 50 : pjesa me e poshtme e çerekut te perparme te perbere prej fundit te kerthizes dhe majes se gjoksit.
- B.** Produktet e mbuluara prej shenimeve shtese 1(A) (a) deri ne (g) te ketij kapitulli mund te paraqiten me ose pa kolonen vertebrale.
- C.** Ne percaktimin e numrit te brinjeve te plota apo te prera te referuara ne paragrafin 1(A), merren ne konsiderate vetem ato qe jane te bashkangjitura me shtyllen kurrizore. Nese shtylla kurrizore eshte hequr, merren ne konsiderate vetem brinjet e plota ose te prera te cilat kane qene bashkangjitur direkt me shtyllen kurrizore.
2. **A.** Shprehjet e meposhtme kane kuptimet sipas percaktimeve per to ketu:
- (a) “trup ose gjysme trup”, per qellimet e nenkrereve 0203 11 10 dhe 0203 21 10 : derra te therur ne forme te trupave te derrave shtepiake te cileve u eshte kulluar gjaku dhe hequr te brendshmet dhe nga te cilet u jane hequr qimet dhe thundrat. Gjysme trupat rrjedhin nga trupat e plote nepermjet ndarjes te çdo vertebre cervikale, dorsale, lumbare dhe sakrale, ndermjet apo pergjate qendres se gjoksit dhe ndermjet symphysis ischio-pubic. Keto trupa dhe gjysme trupa mund te jene me apo pa kokat, kembet, dhjamin qe zgjerohet, veshkat, bishtat apo diafragmat. Gjysme trupat mund te jene me apo pa korden spinale, trute apo gjuhen. Trupat dhe gjysme trupat e dosave mund te jene me apo pa gjendrat e qumeshtit (gjendrat mamale);
- (b) “kofshe” (kembet), per qellimet e nenkrereve 0203 12 11, 0203 22 11, 0210 11 11 dhe 0210 11 31: pjesa e pasme (kaudal) e gjysme trupave duke perfshire kokat, me apo pa kembet, kercinjte, lekuren apo dhjamin poshte lekures. Kofsha (kemba) eshte e ndare nga pjesa tjeter e gjysme trupit keshtu qe ajo perfshin, maksimumi, vertebren e fundit lumbare.
- (c) “fundet e perparme”, per qellimet e nenkrereve 0203 19 11, 0203 29 11, 0210 19 30 dhe 0210 19 60 : pjesa anteriore (kraniale) e gjysme trupit pa koken, duke perfshire kokat, me apo pa kembet, kercinjte, yndyren nen lekure apo lekuren e trashe te jashtme.
- Fundet e perparme jane te ndara nga ajo qe mbetet nga gjysme trupi, keshtu qe ajo perfshin, te pakten, vertebren e peste dorsale.
- Pjesa e siperme (dorsale) e fundit te perparme, nese permban apo jo kocken e sheshte dhe muskujt bashkangjitur, (fundin e qafes i fresket apo ne gjendje te kripur), do te konsiderohet si prerje e ijeve, kur ai eshte e ndare nga pjesa e poshtme (ventrale) e fundit te perparme te pakten nga nje prerje pikerisht poshte kolones vertebrore;
- (d) “shpatullat”, per qellimet e nenkrereve 0203 12 19, 0203 22 19, 0210 11 19 dhe 0210 11 39: pjesa me e poshtme e fundit te perparme nese permban apo jo kocken e sheshte dhe muskujt bashkangjitur, duke perfshire kokat, me apo pa kembet, kercinjte, dhjamin nen lekure apo lekuren e trashe te jashtme.
- Kocka e sheshte dhe muskujt bashkangjitur te paraqitura vec, mbeten te klasifikuara ne kete nenkre si pjese e shpatullave.
- (e) “ijet”, per qellimet e nenkrereve 0203 19 13, 0203 29 13, 0210 19 40 dhe 0210 19 70 : pjesa me e larte e nje gjysme trupi duke u zgjeruar nga vertebra e pare cervikale deri tek vertebra kaudale, duke perfshire kokat, me apo pa fileten, kocken e sheshte, dhjamin nen lekure apo lekuren e trashe te jashtme.
- Ijet jane te ndara nga pjesa me e poshtme e nje gjysme trupi nga nje prerje pikerisht poshte kolones vertebrore;
- (f) “bark”, per qellimet e nenkrereve 0203 19 15, 0203 29 15, 0210 12 11 dhe 0210 12 19 : pjesa me e poshtme e nje gjysme trupi e vendosur midis kofshes (kembes) dhe shpatullave, zakonisht e njohur si “pancea”, me apo pa kocka, por me lekuren e jashtme te trashe dhe me dhjamin poshte lekures;
- (g) “anet per proshute”, per qellimet e nenkrereve 0210 19 10: gjysme trupi i derrit pa koken, faqet, kembet, bishtin, dhjamin shtese, veshkat, fileten, kocken e sheshte, sternumin, kolonen vertebrore, kocken pelvike dhe diafragmen;
- (h) “spencers”, per qellimet e nenkrereve 0210 19 10: ana per proshute pa kofshen, nese eshte apo jo me kocke;

- (ij) “anet tre te katertat”, per qellimet e nenkreve 0210 19 20: anet per proshute pa fundet e perparme, nese jane apo jo me kocke;
- (k) “meset”, per qellimet e nenkreve 0210 19 20: anet per proshute pa kofshet dhe fundin e perparme, nese eshte apo jo me kocke;

Nenkreu gjithashtu perfshin prerje te meseve qe permbajne ind te filetes se mishit dhe barkut ne porcione normale te meseve te plota.

- B.** Pjeset e prerjeve te percaktuara ne paragrafin 2A(f) futen ne te njejtin nenkre, vetem nese permbajne cipen e trashe dhe dhjamin nen lekure.

Nese prerjet futen ne nenkreret 0210 11 11, 0210 11 19, 0210 11 31, 0210 11 39, 0210 19 30 dhe 0210 19 60 jane te rrjedhura nga nje ane per proshute nga te cilat kockat e percaktuara sipas paragrafit 2A(g) jane te hequra, linjat e prerjes duhet te ndjekin ato te treguara ne paragrafin 2A(b), (c) dhe (d) perkatesisht; ne çdo rast, keto prerje apo pjese duhet te permbajne kocka.

- C.** “Nenkreret 0206 49 00 dhe 0210 99 49 përfshijnë, në veçanti, kokat apo gjysmat e kokave të derrave shtëpiakë, me apo pa trutë, faqet apo gjuhët, dhe pjesët prej tyre.

Koka eshte e ndare nga pjesa tjeter e gjysme trupit, si me poshte:

- nga nje prerje e drejte paralele deri tek kraniumi; apo
